



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.02, datë 02.07.2024

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“NDËRTIMI I KOMPLEKSIT TË AKADEMISË SË FUTBOLLIT DURRËS, ME
AMBJENTE SPORTIVE DHE NË FUNKSION TË FONDACIONIT “DYRRAH CITY
FOOTBALL ACADEMY”, ME 1, 2 DHE 3 KATE MBI TOKË DHE 1 KAT
NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË ZONËN E SPITALLËS, BASHKIA DURRËS

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues Fondacionit “Dyrrah City Football Academy”, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:


1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i kompleksit të Akademisë së Futbollit Durrës, me ambjente sportive dhe në funksion të Fondacionit “Dyrrah City Football Academy”, me 1, 2 dhe 3 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë”, me vendndodhje në zonën e Spitallës, Bashkia Durrës, me subjekt zhvillues Fondacionin “Dyrrah City Football Academy”.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhen si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Durrës.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
OGERTA MANASTIRLIU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 21 / 11 / 2024